




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Politikë dhe financa**  
Nr.01-060/01-16003/24 datë: 27.06.2024



Npi – 01/239 datë: 02.07.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 02.07.2024 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**  
E mbajtur më datën: 02.07.2024 (e martë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushu, znj.Adelina Beqaj, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, dhe praktikantet znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.06.2024,
2. Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024,
3. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e drejtorave të Institucioneve lokale arsimore,
4. Propozim-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100 euro për qdo muaj për familjet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

**Pika 1**

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.06.2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 24.06.2024.**

**Pika 2**

Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, sa i përket kësaj pike, është dashur me qenë një zyrtarë prezent në mbledhje që të na e elaboroi këtë raport.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, ky është një joseriozitet nga ekzekutivi, sepse nuk është askush prezent për të na dhënë sqarime. Këtu ka shumë të pa vërteta, dmth. kur flitet për lumin, qka kanë punuar ekzekutivi te lumi, kjo është një dezinformatë për me i mashtruar qytetarët, le të kalon e pastaj diskutojmë në Kuvend.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, është mirë me vazhdu me këtë praktikë të raportimit sepse kjo nuk ka ndodhur përpara, pra me u diskutuar për të gjitha edhe ato që janë diskutuar me qytetarë, sepse unë mendoj se është shumë me rëndësi që me ju raportuar edhe qytetarëve edhe kuvendarëve. Nuk kemi obligim ligjor për me e votuar. Pra edhe unë jam që ta diskutojmë detaisht në Kuvend, por është me rëndësi që të merr pjesë dikush nga ekzekutivi sepse vërtetë nuk po na bajnë hesap hiq.

**znj.Adelina Beqaj;** Raportet gjithëherë janë votuar ndërkaq, informatat jo.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sa i përket prezantimit të këtijë raporti, unë vetëm mund të them se Kryetari është jashë vendit, e edhe drejtorët disa janë në pushime. Unë po propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit për miratim, me propozimin që në mbledhjen e Kuvendit më 04.07.2024 me ardhë dikush nga ekzekutivi dhe me e prezantuar këtë raport. Po e qes në votim kështu pra. Në vazhdim Knstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit të punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024, me vërejtjen që në mbledhjen e Kuvendit më 04.07.2024 të vie dikush nga Ekzekutivi dhe ta prezantojë raportin mjaft voluminoz.**

### Pika 3

#### Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e drejtorave të Institucioneve lokale arsimore

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Po Kryesues, ne jemi takort edhe me qelësin për formimin e këtijë Komisioni. Nuk kam vërejtje për anëtarët e propozuar të këtijë Komisioni, por do të debatojmë më në hollësi në Kuvend.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Knstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e drejtorave të Institucioneve lokale arsimore, sipas qelësit, një anëtar nga Pozita dhe një anëtar nga Opozita.**

### Pika 4

#### Propozim-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100 euro për qdo muaj për familjet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, materialin e keni marrë, është një propozim nga Kryetari për me i nda nga 100 euro për ç' do muaj për familjet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore. Sa e di unë sot i kemi 3 familje të tilla në komunën tonë, por sigurisht që nëse ka edhe të tjera ato dhe të tjerat do të paraqiten me kërkesat e tyre në Komunë duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm. E hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Aselina Beqaj;** Faleminderit për propozimin, unë personalisht i njoh dy familje që kanë fëmijë pa përkujdesje prindërore. Kta i marrin nga 350 euro në muaj rregullisht për çdo fëmijë, por sidoqoftë unë mendoj se nga 100 euro janë pak, mendimi im është me ju nda nga 250 euro mirëpo me që është fillimi edhe unë pajtohem se ndoshta më vonë rritet. Pyetja ime është se këto 100 euro a i marrin për secilin fëmijë apo për familje? Unë mendoj se kte duhet ta qartësojmë për Kuvend.

**z.Përparim Ramusa;** Në parim e mbështes këtë vendim, po ashtu jam për me e rritë këtë shumë, sepse mendoj se e meritojnë këto familje. Mjetet financiare qojnë peshë të madhe sepse rritja e një fëmiju sot ka kosto të lartë, prandaj shumëën ta lëmë të hapur për Kuvend dhe nëse ka mjete financiare përmes subvencioneve atëher ta rrisim shumëën. Logjika e kapë që pagesat me u kry nga dita e miratimit në Kuvend.

**znj.Zejnije Veliu;** Përshëndetje, kuptohet që kësaj kategorie sado që i ndihmojmë janë të pa mjaftueshme. Por tani për tani Komuna ka mundësi financiare me i nda nga 100 euro, është një hap i mirë që të përkrahen këto familje, edhe me rëndësi është të bëhet hapi i parë, sepse mendoj se kjo shumë do të rritet në të ardhmen. Sa e di unë ato familje përkrahen edhe nga Ministria. U përmend këtu mirënjohja për këto familje, ajo mirnjohje u është ndarë në emër të Grupit jo formal të Grave, jo në mënyrë individuale siç u tha.

**z.Përparim Ramusa;** Është mirë me bisedu me drejtorin e financave, nëse ka mundësi që kjo shumë të rritet, atëher le ta rrisin.

**z.Lumni Amrushi;** I dimë këto se far familje janë, moti qysh si fëmijë e di. shtë mirë me e sqaruar Drejtoria e Financave me Drejtorinë për Shëndetësi nëse ka mundësi rritje ose jo deri në mbledhjen e Kuvendit, kështu që së paku me bërë 150 euro deri në Shtator e pastaj e planifikojmë më mirë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë kam biseduar me Besnikun, sepse kjo është temë e ndjeshme, dhe ai më ka thënë se tash për tash nuk mundet me u rritë më shumë, e më vonë do ta shohim mundësinë, sepse me thanë të vërtetën edhe unë e besoj edhe tjerët janë për me e rritë këtë shumë.

**znj.Aselina Beqaj;** Unë po insistoj që mos me i lanë me 100 euro, por së paku 250 euro për familje ose 100 euro për secilin fëmijë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100 euro për qdo muaj për familjet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore, me kërkesën që të shikohet mundësia financiare për me rritë shumën nga 100 euro në 150 euro.**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:52h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF  
Adnan Ademi

